

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 7703, DATË 11.05.1993 PËR SIGURIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, TË NDRYSHUAR”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij projektaktit, konsiston në përjashtimin e përfituesve të pensionit të pleqërisë të cilët vetëpunësohen në sektorin privat, pasi kanë fituar të drejtën për pension pleqërie, nga pagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore, duke qenë se atyre nuk u njihet si periudhë sigurimi koha e vetëpunësimit, sipas pikës 3 të VKM Nr. 551, datë 08.11.1993 “Për lejimin e pagesës së pensionit të pleqërisë për pensionistët e punësuar ose të vetëpunësuar në sektorin privat”, ndërkohë që paguajnë kontribute.

II. VLERËSIMI I PROJEKAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektakti që paraqitet për shqyrtim bën pjesë në aktet ligjore që përcaktojnë dhe saktësojnë procedurat për zbatimin e dispozitave të legjislacionit të propozuar nga Këshilli i Ministrave për lehtësimin e përfituesve të pensionit të pleqërisë të cilët vetëpunësohen në sektorin privat nga barra e pagimit kontributeve, duke qenë se atyre koha e vetëpunësimit nuk u njihet si periudhë sigurimi.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT, LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT DHE EFEKTET E PRITSHME

Përmes nismës së Këshillimit Kombëtar qytetarëve ju kërkua të jepnin mendim, në lidhje me faktin nëse pensionistët të cilët vetëpunësohen në sektorin privat duhet të përjashtohen nga pagesa e kontributeve të detyrueshme për sigurime shoqërore. Nga rezultatet e kësaj nisme evidentohet fakti se 66% e qytetarëve kanë dhënë përgjigje pozitive. Me qëllim shmangien e detyrimit për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore të personave të cilët përfitojnë pensionin e pleqërisë dhe vetëpunësohen në sektorin privat, duke qenë se atyre nuk u njihet koha e vetëpunësimit si periudhë sigurimi. Në këtë kuptim, efekti i pritshëm i projektaktit është lehtësimi i këtyre

personave nga barra e pagesës së kontributeve të cilat deri më sot nuk u njihen si periudhë sigurimi.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi që paraqitet për shqyrtim bazohet në nenet 78, 83, pika 1, dhe 100, të Kushtetutës.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE

Nuk bën pjesë në aktet që kërkohet të ketë përafrim me “acquis communautaire”.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKAKTIT

Në këtë projektligj është parashikuar që Këshilli i Ministrave mund të vendosë që përfituesit e pensionit të pleqërisë të mos paguajnë kontribute për sigurimet shoqërore në rast se zgjedhin të vetëpunësohen në sektorin privat dhe njëkohësisht të tërheqin këstet e pensionit të pleqërisë.

Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ndryshohet si më poshtë:

Neni 1

Neni 98, i Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ndryshohet si më poshtë:

“Neni 98

Këshilli i Ministrave mund të vendos që përfituesit e pensionit të pleqërisë të vetëpunësuar në sektorin privat të tërheqin këstet mujore të pensionit dhe të përjashtohen nga pagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore, gjatë kohës së vetëpunësimit.”

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren Zyrtare” dhe shtrin efektet nga kjo datë.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTVENDIMIT

Për zbatimin e këtij ligji ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTVENDIMIT

Ky projektakt është hartuar nga Këshilli i Ministrave në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Aktualisht janë 1 484 përfitues të pensionit të pleqërisë të vetëpunësuar në sektorin privat të cilët paguajnë kontribute çdo muaj në masën 14,151,424 lekë, të cilat kalojnë në fondin e sigurimeve shoqërore. Shuma 169,817,088 lekë në vit me hyrjen në fuqi të këtyre ndryshimeve do të zbritet nga të ardhurat në fondin e sigurimeve shoqërore.

Efektet financiare të këtij ligji fillojnë nga data e hyrjes së tij në fuqi.

PROPOZUESI

KRYEMINISTRI

EDI RAMA